

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.17.02.2023*

17.02.2023

Ora 11:20

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ:      **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,  
Znj. V. Ballgjini**

• **Parti Politike:      PDIU (Z. K. Xhemali)**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita të gjithëve! Në seancë kemi 2 çështje në rend dite. Pika e parë ka të bëjë me projektvendimin “Për shpërndarjen e fondeve, partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2023”. Pika e dytë ka të bëjë me përfundimin e shqyrtimit administrativ për raportimet e institucioneve publike, për periudhën 3 shkurt deri në 9 shkurt 2023. Vijojejmë me pikën e parë të rendit të ditës.

**Z. Y. Merkaj:** KRIIK ka dërguar një email. Kërkon shtyrjen e mbledhjes, sepse pretendon që nuk është llogariur mirë shpërndarja e fondit.

**Z. I. Celibashi:** Ne do e shtyjme në fakt. Me gjithë respektin për KRIIK-un dhe kërkesën e KRIIK-ut, i cili ka patur kohën në dispozicion prej më shumë se një javë për të verësuar dhe për të paraqitur kërkesën për shtyrje dhe jo për ta paraqitur

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.17.02.2023*

atë vetëm 10 minuta apo 15 minuta përpara zhvillimit të seancës. Do e shtyjmë sepse partitë politike të interesuara drejtpërsëdrejti për këtë projektvendim, nuk kanë patur kohën e mjaftueshme për ta vlerësuar draftin e këtij projektvendimi. Kështu që do të shtyhet për një ditë tjetër. Apo jo i nderuar, dakord?

**Z. K. Xhemali, përfaqësues i Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet:** Në ndihmesë dhe të administratës në kushtet që po shtyhet kjo seancë duhet t'ju kujtoj për subjektin Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, e cila në këtë relacion është më dy mandatë, ndërkohë realisht është me tre mandate.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, besoj se deri të mërkurën mund të zhvillojmë seancën tjetër publike. Është koha e mjaftueshme për të rivlerësuar edhe njëherë përmbajtjen e këtij projektvendimi. Parë ky edhe në raport me parashikimet e ligjit “Për Partitë Politike”. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.17.02.2023*

17.02.2023  
Ora 11:24

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Përfundimi i hetimit administrativ të raportimeve të organeve publike për periudhën 3 shkurt – 9 shkurt 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Z. Ilirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ:

**Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,**

**Znj. V. Ballgjini**

• **Parti Politike:**

**PDIU (Z. K. Xhemali)**

**Z. I. Celibashi:** Në lidhje me pikën e dytë të rendit të ditës për vlerësimin e veprimtarisë të institucioneve publike, për periudhën 3 shkurt - 9 shkurt 2023.

**Znj. M. Koja:** Atëherë, në përfundim të shqyrtimit administrative, të raportimeve të institucioneve publike, për periudhën e monitorimit 3 - 9 shkurt 2023, ka përfunduar hetimi administrativ dhe pasi u administruan të gjitha provat, faktet dhe parashtrimet e institucioneve, ne propozojmë të përfundojmë procedimin administrativ ndaj institucioneve si vijon:

1. Kryeministria
2. Ministria e Arsimit dhe Sportit
3. Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin
4. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
5. Ministria e Drejtësisë

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.17.02.2023*

6. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
7. Ministria e Kulturës
8. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
9. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
10. Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Elbasan
11. Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës
12. Këshilli i Qarkut Berat
13. Bashkia Berat
14. Bashkia Durrës
15. Bashkia Fier
16. Bashkia Kavajë
17. Bashkia Kuçovë
18. Bashkia Lushnjë
19. Bashkia Vorë

Ndërkohë, është konstatuar në shkelje të afatit Bashkia Fier, Kavajë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale por, arsyet që kanë dhënë kanë të bëjnë me përlllogaritjen gabim të afatit. Nuk ka ndonjë mungesë vullneti nga ana e tyre, prandaj në vendimmarrje do të dalim me një tërheqje vëmendje për të llogaritur saktë 5 ditë, pasi janë në kushtet e 4 ditëve përpara zhvillimit të veprimtarisë dhe jo 5 ditëve. Kështu që dalim me një tërheqje vëmendje për këto 3 institucione. Raportimet e tjera kanë qenë për shkak të pjesëmarrjes. Kanë qenë të ftuar dhe jo organizator të veprimtarive. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po, për gjithë të tjerët nuk ka shkaqe ligjore për të vendosur sanksione?

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të*  
*Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*  
*Dt.17.02.2023*

*Znj. M. Koja:* Jo.

*Z. I. Celibashi:* Dakord, atëherë do t'jua risjellim në vëmendje edhe njëherë këtyre institucioneve mënyrën e llogaritjes së afatit dhe meqenëse bëhet fjalë për një ditë diferencë, po i dërgojmë një tërheqje vëmendje për këtë dhe me këtë konkluzion mbyllim këtë pikë të rendit të ditës. Mbyllim seancën, faleminderit, ditë të mbarë!

**Vendimi nr. 59**

*Zbardhi materialin audio*  
*Arlinda BAHOLLARI*

